



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 36

Tiranë – E enjte, 20 shkurt 2025

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 3/2025, datë 30.1.2025	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 ‘Për buxhetin e vitit 2024’”, i ndryshuar..... 3737
Dekret i Presidentit nr. 41, datë 19.2.2025	Për shpallje ligji..... 3737
Ligj nr. 6/2025, datë 30.1.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar..... 3737
Dekret i Presidentit nr. 42, datë 19.2.2025	Për shpallje ligji..... 3739
Ligj nr. 10/2025, datë 17.2.2025	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar..... 3739
Dekret i Presidentit nr. 43, datë 20.2.2025	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit 3741

**LIGJ**
Nr. 3/2025**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV,
ME FUQINË E LIGJIT, NR. 5, DATË
19.12.2024 “PËR DISA NDRYSHIME DHE
SHTESA NË LIGJIN NR. 97/2023 ‘PËR
BUXHETIN E VITIT 2024’”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 101 dhe 160 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 19.12.2024, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023 ‘Për buxhetin e vitit 2024’”, i ndryshuar.

Miratuar në datën 30.1.2025.

**Shpallur me dekreten nr. 41, datë 19.2.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET
Nr. 41, datë 19.2.2025**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 3/2025, “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 19.12.2024, ‘Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2023, ‘Për buxhetin e vitit 2024’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 6/2025**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 8952, DATË 10.10.2002,
“PËR LETËRNJOFTIMIN
ELEKTRONIK TË SHTETASVE
SHQIPTARË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në titullin e ligjit pas fjalës “elektronik” shtohen fjalët “dhe digjital”.

Neni 2

Në nenin 1 pas fjalëve “letërnjoftim unik,” shtohen fjalët “elektronik ose digjital”.

Neni 3

Në nenin 2 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pas fjalisë së parë të pikës 1 shtohen fjalitë me këtë përmbajtje:

“Letërnjoftimi mund të jetë në formë elektronike ose digjitale. Në çdo rast, shtetasit mund të zgjedhin për t’u pajisur me një nga format e letërnjoftimit ose mund të pajisen njëkohësisht me letërnjoftimin në të dyja format, elektronike dhe digjitale.”.

2. Në pikën 4 pas fjalës “Letërnjoftimi” shtohet fjala “elektronik”.

3. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Rregullat dhe procedurat për paraqitjen e kërkesës për pajisjen me letërnjoftimin elektronik e digjital, pajisja, si dhe dokumentet e nevojshme, që shoqërojnë kërkesën, përcaktohen me udhëzim të ministrit të Brendshëm.”.



Neni 4

Në paragrafët e parë dhe të dytë të nenit 4 fjala “elektronik” hiqet.

Neni 5

Neni 5 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 5

Shtetasi pajiset me letërnjoftim të ri kur plotëson kushtet e nenit 3 të këtij ligji dhe kur:

- a) njëri nga përbërësit e gjendjes civile, të pasqyruar në letërnjoftim, ka ndryshuar, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi; ose
- b) vërtetohet nga organet përkatëse se letërnjoftimi i ka humbur ose i është vjedhur; ose
- c) është dëmtuar; ose
- ç) në çdo rast tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi.”.

Neni 6

Në nenin 5/1 shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) vërtetohen rastet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.”.

Neni 7

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1 dhe në paragrafin e parë pas fjalës “Letërnjoftim” shtohet fjala “elektronik”.

2. Pas paragrafit të parë shtohen pikat 2 dhe 3 me këtë përmbajtje:

“2. Letërnjoftimi digjital është dokument identiteti në të cilin janë pasqyruar qartë dhe janë shënuar me metoda digjitale të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni. Përveç elementeve të pikës 1 të këtij neni, në letërnjoftimin digjital përfshihen edhe:

- a) çelësi kriptografik, që mundëson identifikimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
- b) informacioni, i cili mundëson nënshkrimin digjital, duke përfshirë një çelës kriptografik, që mundëson nënshkrimin digjital dhe certifikatën përkatëse;
- c) të dhëna të tjera teknike, të nevojshme për funksionimin ose përdorimin e identitetit digjital.

3. Të dhënat e tjera teknike, që përfshihen në letërnjoftimin digjital sipas shkronjës “c” të pikës 2 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 8

Pas nenit 6 shtohet neni 6/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 6/1

1. Shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike është përgjegjëse për:

- a) krijimin e letërnjoftimit digjital dhe të infrastrukturës teknike e teknologjike për garantimin e sigurisë dhe të besueshmërisë së letërnjoftimit digjital;
- b) administrimin e bazës së të dhënave shtetërore për letërnjoftimin digjital;
- c) krijimin e kushteve për kryerjen e transaksioneve digjitale ndërmjet palëve të treta edhe nëpërmjet përdorimit të letërnjoftimit digjital.

2. Shoqëria aksionare përgjegjëse për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike mund t'i përbushë përgjegjësitë e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “c” të pikës 1 të këtij neni vetë ose nëpërmjet shoqërive të tjera, që kanë eksperiencën dhe kapacitetet teknike e financiare për krijimin e letërnjoftimeve digjitale, në përputhje me parashikimet e legjislacionit të posaçëm në fuqi.”.

Neni 9

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor të parashikuar në nenin 7 të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministri i Brendshëm që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktin nënligjor të parashikuar në nenin 3 të këtij ligji.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.1.2025.

Shpallur me dekretin nr. 42, datë 19.2.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

**DEKRET**

Nr. 42, datë 19.2.2025

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 6/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, ‘Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

**LIGJ
Nr. 10/2025****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË LIGJIN NR. 10 019, DATË 29.12.2008,
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 e 2, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 25 pika 8 ndryshohet si më poshtë:

“8. Kur zgjedhësi që ka paraqitur kërkesë në listën e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë vëren se nuk është i regjistruar në këtë listë ose regjistrimi i tij ka pasaktësi, ai ka të drejtë të paraqesë kërkesë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë deri 30 ditë përpara datës së

zgjedhjeve. Kërkesa mund të paraqitet edhe *online* nëpërmjet një platforme elektronike të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor. Kërkesa sipas kësaj pike përjashtohet nga taksa gjyqësore. Gjykata shqyrton dhe vendos për kërkesën, sipas kësaj pike, nëpërmjet kësaj platforme brenda 48 orëve nga data e regjistrimit të kërkesës. Emrit dhe të dhënave të tjera të zgjedhësit, që i shtohen listës së zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, i bashkëngjitet vendimi i Gjykatës.”.

Neni 2

Në nenin 25/1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Titulli i nenit 25/1 ndryshon dhe bëhet: “Procedura e votimit nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”.

2. Pika 3 ndryshon si më poshtë:

“3. Fletët e votimit të plotësuara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të sekretuara dërgohen në adresën zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nëpërmjet shërbimit postar. Shpenzimet për dërgimin dhe kthimin e fletës së votimit dhe çdo materiali tjetër zgjedhor dhe informativ nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek votuesit nga jashtë paguhet nga KQZ-ja. KQZ-ja fillimisht bën përpjekje të përzgjedhë ofrues ndërkombëtarë të shërbimit postar me jashtë vendit, që kanë eksperiencë dhe reputacion të mirë në shërbimin e postës së shpejtë, dhe zgjedhja e tij realizohet nëpërmjet procedurave më afatshkurtra që mundëson legjislacioni për prokurimin publik.”.

3. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 3

Pas nenit 25/1 shtohet neni 25/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/2**Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë
territorit të Republikës së Shqipërisë
dhe rezultati zgjedhor**

1. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në momentin e mbërritjes në KQZ regjistrohen në një regjistër të posaçëm dhe ndahen sipas zonës



zgjedhore të vendbanimit më të fundit të zgjedhësit para largimit nga Shqipëria.

2. Fletët e votimit të dërguara nga zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe të administruara nga KQZ-ja numërohen dhe vlerësohen në vendin e numërimit të votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të caktuar nga KQZ-ja.

3. Procesi i numërimit të tyre fillon në të njëjtin moment kur fillon numërimi i kutisë së parë me fletë votimi të zonës zgjedhore përkatëse.

4. Numërimi dhe vlerësimi i votave nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë administrohet nga një komision i përbërë prej 4 anëtarësh dhe sekretari, të emëruar nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Propozimi për 2 anëtarë bëhet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe për 2 anëtarët e tjerë propozimi bëhet nga partia më e madhe e pakicës parlamentare. Sekretari i komisionit emërohet në bazë të aplikimeve të lira dhe duhet të jetë me profesion jurist. Anëtarët dhe sekretari duhet të plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenet 30 dhe 31 të këtij Kodi. Nëse numri në listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë është më i madh se 80 mijë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mund të ngrejë më shumë se një komision të numërimit dhe të vlerësimit të votave nga jashtë, me kushtin që vlerësimi i votave të një qarku të kryhet nga i njëjti komision.

5. Për numërimin dhe vlerësimin e votave Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve cakton grupe numërimi të përbërë nga dy anëtarë. Një anëtar propozohet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare dhe anëtari tjetër nga partia më e madhe e pakicës parlamentare.

6. Rregullatori, me propozimin e Komisionerit, përcakton me akt nënligjor dokumentacionin, mënyrën e plotësimit të tij dhe çdo aspekt tjetër për administrimin, vëzhgimin e procesit të numërimit, numërimin, vlerësimin e votës dhe tabelimin e rezultatit zgjedhor sipas këtij neni.”.

Neni 4

Në nenin 64, pika 1, togfjalëshi “70 ditë “ zëvendësohet me togfjalëshin “75 ditë”.

Neni 5

Në nenin 65, pika 1, togfjalëshi “60 ditë “ zëvendësohet me togfjalëshin “70 ditë”.

Neni 6

Në nenin 67, pika 1, në fjalinë e parë togfjalëshi “50 ditë “ zëvendësohet me togfjalëshin “60 ditë”.

Neni 7

Në nenin 69 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 togfjalëshi “50 ditë “ zëvendësohet me togfjalëshin “60 ditë”.

2. Në pikën 3 togfjalëshi “70 ditë “ zëvendësohet me togfjalëshin “75 ditë”.

Neni 8

Në nenin 73 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 togfjalëshi “45 ditë” zëvendësohet me togfjalëshin “55 ditë”.

2. Në pikën 2 togfjalëshi “42 ditë” zëvendësohet me togfjalëshin “52 ditë”.

Neni 9

Në nenin 84, pika 5, pas fjalisë së parë shtohet një fjali me këtë përmbajtje:

“Koha e përgjithshme e transmetimit të reklamave politike për kandidatët e listës shumëmbrore, që i nënshtrohen votimit parapëlqyes të secilit subjekt zgjedhor, nga secila radio dhe televizion privat nuk mund të jetë më shumë se 140 minuta.”.

Neni 10

Në nenin 92/2 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Kandidatët e partisë politike ose koalicionit zgjedhor të regjistruar si subjekt zgjedhor kanë të drejtë të vetëfinancojnë fushatën e tyre deri në shumën 3 milionë lekë. Deklarimi i këtij vetëfinancimi paraqitet nga kandidati së bashku me raportin financiar të dorëzuar nga subjekti zgjedhor që i përket, sipas nenit 92/3 të këtij Kodi. Kandidati



bën deklarinimin sipas kësaj pike në përputhje me modelet e miratuara nga KQZ-ja. KQZ-ja miraton modelet e raportimit financiar të kandidatëve të subjekteve zgjedhore brenda 10 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Shkelja e përcaktimeve të bëra në këtë pikë nga kandidati i subjektit zgjedhor u nënshtrohet sanksioneve të parashikuara në nenin 173 të këtij Kodi.”.

2. Në pikën 4 fjalía e parë ndryshohet si më poshtë:

“4. Shuma e shpenzimeve të bëra nga një subjekt zgjedhor, pa përfshirë kandidatët e tij, për fushatën zgjedhore, nuk duhet të jetë më shumë se 5 herë më e madhe se shumá më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të këtij Kodi.”.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 17.2.2025.

**Shpallur me dekretin nr. 43, datë 20.2.2025,
të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bajram Begaj.**

DEKRET

Nr. 43, datë 20.2.2025

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 10/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

Neni 2

Dhënie e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 10/2025, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 019, datë 29.12.2008, ‘Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 32 lekë